



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 146/24

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 15. 07. 2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 korrik 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024, mbajtur më datë 27 qershor 2024.
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin "Adem Voca" në fshatin Pasomë.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për z. Milaim Fejzullahu, ish-komandant i Policisë së Kosovës.
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2024.
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr.02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës për periudhën janar-qershor 2024.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit lidhur dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në fshatin Lumadh.
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2023.
14. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për Klubin e Hendbollit "Samadrexha" F.
15. Pyetje dhe përgjigje.

